

VENDIM
Nr.6, datë 6.1.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË TEPELENË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1367 (një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Tepelenë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-17	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
18-23,67-72,145-238,240-415,416-1156 (vetëm sheshet dhe lulishtet)	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
31-52	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
53-66,73,74-77,93-108	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
109-134	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
142-144	Varrezat publike	Në pronësi
416-1156 (vetëm troje të lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
1183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
1357	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
1358	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim